



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK

Në mbrojtje të dinjitetit të mjekut tonë

28 prill 2020  
Prishtinë

Oda e Mjekëve të Kosovës ka pranuar me shqetësim lajmin se konvoji me mjekë dhe infermjerë nga Republika e Serbisë ka kërkuar që të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës nën pretekstin e monitorimit të gjendjes shëndetësore nëpër enklavat serbe.

Konsiderojmë se qasja e tillë është e papranueshme, marr për bazë se veprimet të tilla janë duke shfaqur mosbesimin e hapur etnik dhe se shteti serb me veprime të tilla po tenton ta pasqyroj shtetin, institucionet dhe profesionistët tone si të pabesueshëm, papranueshëm apo në rastin më “humanitar” të pamjaftueshëm për të menaxhuar apo përkuqdesur për qytetarët e vet joshqiptar. Kështu janë duke u krijuar segregacione institucionale në mes të serbëve të Kosovës dhe institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës me bekimin tonë.

Andaj shtrohen pyetjet:

1. Ne nuk kemi kapacitete për të monitoruar këta bashkëqytetar tonë? Kemi dhe ate me bollëk!
2. Nuk dashkan mjekët tonë dhe apo institucionet tona të bëjnë detyrën e tyre? Jemi të gatëshëm dhe pa asnjë paramendim!
3. Mjekët tonë janë të padijshtëm apo të pakët në numër? Dija jonë është e mjaftueshme për të gjithë dhe kemi 600 mjek të papunë dhe vullnetar poashtu edhe 100 specialist të pa punë!

Andaj kërkojmë nga autoritetet kompetente që të jenë të vëmendëshme në raport me menaxhimin e situatave të tilla që çënojnë sistemin shëndetësor dhe zbatimit të ligjit sipas në trajtimin të barabartë dhe denigrojnë kredibilitetin e mantelbardhëve tonë jo-serb.

Prishtinë, 28 prill 2020

Këshilli Drejtues i OMK-së

